

KONTRATË

Numri i kontratës¹: 613-24-2008-2-3-6/C935

Komunës së Lipjanit të cilën e përfaqëson, **Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Bekim Shabani** në njërën anë (në tekstin e mëtejshëm) Autoriteti Kontraktues dhe,

PROGLOBAL SH.P.K., 28 Nentori, nr. 129, Prishtinë, 811500794, (ne vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Mbushja dhe servisim të bombolave kundër zjarrit me numër identifikues: 613-24-2008-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Aparatet (bombolat)** për fikje të zjarrit duhet të servisohen dhe të mbushen në çdo 6 muaj sipas ligjeve në fuqi, tipi dhe lloji aparateve janë të përshkruara në paramasë, dmth. secili aparat duhet të servisohet dhe rimbushet 6 herë gjatë 3 viteve sa do të zgjasë kjo kontratë.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **08.04.2024** dhe përfundon me **07.04.2027**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **3** ditë nga data e marrjes e kërkesës nga menaxheri i kontratës.

1.4 Vendi i **[dërgimit të furnizimeve] [ekzekutimit të punëve] [kryerjes së shërbimeve]** do të jetë **Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Lipjan Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) nëpër fshatra, Gadime, Magure, Shalë dhe Janjevë dhe Ambulantat Mjekësisë Familjare (AMF) që janë në fshatrat e Komunës së Lipjanit**

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **[1,056.00] €; [njëmijë pesdhjetë e gjashtë euro e zero cent]** Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të shërbimeve për servisim dhe rimbushje të bombolave (aparateve kundër zjarrit) për të cilën menaxheri i kontratës do të hartojë raport me shkrim se shërbimet janë kryer sipas kushteve të kontratës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i [furnizimeve] [shërbimeve] duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Kontraktuesi me rastin e nënshkrimit të kontratës do të dorëzojë sigurimin e ekzekutimit në vlerë prej 1000.00€ në kohëzgjatje prej 37 muaj.

7.2 gjatë kësaj kohe do të jetë përgjegjësi e kontraktuesit. Sigurimi i ekzekutimit njëherit është garancion për kualitetin e shërbimeve të kryera.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, shërbimet e kryera sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, shërbimet kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar, menaxher i kontratës caktohet Alban Bytyqi, ndërsa mbikqyres Agim Bytyqi.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g)

Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashttrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet gjykata themelore e vendit në pajtim me ligjin në Kosovë.ose

b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë..

Neni 14 Komunikimi


14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	BECIM SHABANI	Emri:	ARDIAN VUKIĆ
Pozita:	DREJTOR	Pozita:	MANAGER
Nënshkrimi:	<i>F. Shabani</i>	Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	08.04.2024	Data:	
Vula:		Vula:	



**Paramasa për mbushje dhe servisim të bombolave kundër zjarrit në QKMF
„Mehdi Zejnullahu" Lipjan**

Nr.	Cope	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	1	Mbushje dhe servimi i aparatit kundër zjarrit: Tip -CO2	mbushje (servisim)	6	6.50	39.00
2	8	Mbushje dhe servisimi i aparatit kundër zjarrit: Tip -S9	mbushje (servisim)	48	9.50	456.00
3	11	Mbushje dhe servisimi i aparatit kundër zjarrit: Tip -S6	mbushje (servisim)	66	8.50	561.00
		shuma e pëgjithshme				1056.00

Lipjan

Data:

04.03.2024

Vërejte:

Sasia e aparateve (bombolave) është në kolonën e dytë.

Kjo kontratë lidhet për 3 (tri)vite , aparatet(bombolat)për fikjen e zjarrit është obligim që të servisohen dhe rimbushen në çdo 6 muaj, në kolonën nr.5 numri i mbushjeve deri sa zgjatë kjo kontratë